



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 671/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Shedula” shpk dhe “Vetefarm-Jugu” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-31521-07-25-2019, me objekt “*Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinarë*”, me fond limit 16,499,987 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 02.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ankimues: “Milifar” shpk
Rruga “Xh.Martini” 33, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë

Subjekt i Interesuar: “Shedula” shpk
Lagjia 14, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-31521-07-25-2019, me objekt “*Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare*”, me fond limit 16,499,987 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 02.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

II.2. Në datën 02.09.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 06.09.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Shehdula	13,353,960	I kualifikuar
- Milifar	13,867,960	I kualifikuar
- Vetal	15,973,664.37	I skualifikuar
- Vetefarm-Jugu	16,295,460	I kualifikuar

II.4. Në datën 13.09.2019 operatori ekonomik ankimues “Milifar” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Kompania Milifar shpk nuk është dakord me vlerësimin që ka bërë komisioni i vlerësimit të ofertave pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit për këtë prokurim. Ne kërkojmë që dy subjektet e tjera që janë kualifikuar Shedula dhe Vetfarm-Jugu të skualifikohen për arsye se këto dy subjekte kanë patur probleme me mostrat.*
- *Konkretisht Produkti Mostër me nr. rendor 18 dhe me emrin Bisturi nr.21 –Kjo mostër nga dy subjektet Shedula dhe Vetfarma Jugu është paraqitur vetëm maja dhe jo bishti i bisturisë. Duhet të jemi të qartë se me produktin bisturi kuptohet maja dhe bishti i bisturisë pra ky produkt nuk mund të ndahet në pjesë të vecanata por është një i vetëm që të kryejë funksionin e vet gjatë operimit. Pra ky produkt mostër nuk është i plotë dhe duhet të konsiderohet nga komisioni që mungon në mostrat e këtyre subjekteve.*
- *Produktet mostër me nr. rendor 20, 23 dhe me emërtim: Mbulesë një përdorim sterile dhe Përparëse operimi një përdorimshe. Këto dy mostra nuk janë të plota sepse duke u nisur nga kriteri bazë në vlerësim ku të gjitha mostrat duhet të kenë në datën e dorëzimit skadencën minimalisht një vit. Realiteti është se këto dy subjekte kanë paraqitur këto mostra pa datë prodhimi dhe skadimi ndonëse këto produkte janë kërkuar të jenë sterile dhe data e skadencës të produkteve sterile nga ana teknike është shumë e domosdoshme dhe e rëndësishme që të ruajë një fushë operative sterile përndryshe kur mungon data e prodhimit dhe skadencës nuk duhen përdorur pasi janë të dëmshme sepse shkaktojnë infeksione të rënda të plagës së operuar. Kjo u konstatua në castin e dorëzimit të mostrave dhe u kontestua nga ana jonë dhe morrëm një përgjigje absurde , jo profesionale jashtë cdo lloj etike të një personi që në administratën shtetërore nga personi përgjegjës i prokurimeve. Kjo na detyroi që ne të mos firmosim procesverbalin e dorëzimit të mostrave se nuk u shënua kjo mungesë e datës së prodhimit dhe skadencave për këto dy produkte për këto dy subjekte. Këto mostra duhet të konsiderohen si mostra jo të sakta por si mungesa dhe të merret vendim për skualifikimin e këtyre subjekteve.*
- *Produkti mostër me numër rendor 30 dhe me emërtim: Fipronil 10-25 kg. Duhet të dihet dhe të sqarohet që në fillim sepse në veterinari nuk prodhohen produkte Spot On me përmbajtje*

Fipronili për qen të peshave 10-25 kg sepse ky produkt nga përmbajtja e fipronilit 134 mg ose 1.34 ml për pipet nuk mund të japi efekt për peshat 10-25 por vetëm për peshat 10-20 kg. Pra nga ana teknike nuk është i realizueshëm. Ky problem për këtë mostër 10-25 kg u është kërkuar nga ana jonë në shkresën ankimese nr.1828 prot datë 02.08.2019 autoritetit tuaj që të shikohet kjo mostër dhe të ndryshojë mostra në paketimet 10-20 dhe 20-40 sepse ky produkt me këtë përmbajtje prodhohet vetëm në këto paketime por cuditërisht morra nga ju një përgjigje negative dhe jashtë cdo kriteri teknik. Duke u nisur nga kjo përgjigje ju për të eliminuar konkurrencën e ndershme dhe barazinë në tendera ju detyruat, nxitët, suportuat dy subjektet e mësipërme që të sjellin mostra të fallsifikuara me përmbajtje Filpronili dhe në paketim një pipet për peshat 10-25 kg. Kërkojmë nga ana juaj që të merren masa për këtë fallsifikim që kanë bërë këto dy subjekte me skualifikimin e tyre nga ky tender dhe problemi të mos shkojë në organet e drejtësisë, anti korupsionit dhe medja.

Duke u nisur nga argumentat e mësipërme që janë shumë objektive të vërteta dhe të pakundështueshme kërkojmë nga ana juaj që këto dy subjekte të skualifikohen dhe subjekti Milifar shpk të shpallet fitues.

- *Gjithashtu dyshoj që këta operatorë:*
- *Nuk vërtetojnë shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha detyrimet e duhura aktuale kriter ky i përcaktuar në kriteret e vecanta të kualifikimit sepse nuk vërtetojnë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.*
- *Dyshoj se këta operatorë ekonomikë nuk kanë plotësuar saktë deklaratën për paraqitje oferte të pavarur.*

II.5. Me shkresën nr.2075/1 prot datë 17.09.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje OE ankimes duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 26.09.2019 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku përvec pretendimeve të mësipërme drejtuar autoritetit kontraktor ka shtuar objektin e ankesës duke kërkuar skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Shedula” shpk dhe “Vetefarma Jugu” shpk edhe për mungesë të sigurimit të ofertës si dhe mosplotësim në formën e duhur të deklaratës për kriteret e përgjithshme me të gjithë personat drejtues, mbikqyrës etj.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.2209/1 prot datë 07.10.2019 protokolluar me tonën me nr.1532/2 prot datë 07.10.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Milifar” shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik “Shedula” shpk me argumentat se “Produkti mostër me numër rendor 30 dhe me emërtim: Fipronil 10-25 kg. Duhet të dihet dhe të sqarohet që në fillim sepse në veterinarin nuk prodhohen produkte Spot On me përmbajtje Fipronili për qen të peshave 10-25 kg sepse ky produkt nga përmbajtja e fipronilit 134 mg ose 1.34 ml për pipet nuk mund të japi efekt për peshat 10-25 por vetëm për peshat 10-20 kg. Pra nga ana teknike nuk është i realizueshëm. Ky problem për këtë mostër 10-25 kg u është kërkuar nga ana jonë në shkresën ankimuese nr.1828 prot datë 02.08.2019 autoritetit tuaj që të shikohet kjo mostër dhe të ndryshojë mostra në paketimet 10-20 dhe 20-40 sepse ky produkt me këtë përmbajtje prodhohet vetëm në këto paketime por cuditërisht morra nga ju një përgjigje negative dhe jashtë cdo kriteri teknik. Duke u nisur nga kjo përgjigje ju për të eliminuar konkurrencën e ndershme dhe barazinë në tendera ju detyruat, nxitët, suportuat dy subjektet e mësipërme që të sjellin mostra të fallsifikuara me përmbajtje Filpronili dhe në paketim një pipet për peshat 10-25 kg. Kërkojmë nga ana juaj që të merren masa për këtë fallsifikim që kanë bërë këto dy subjekte me skualifikimin e tyre nga ky tender dhe problemi të mos shkojë në organet e drejtësisë, anti korupsionit dhe medja”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- Në datën dhe orën e hapjes së procedurës ofertuesit duhet të paraqesin mostra për artikujt e tabelës së mëposhtme, pranë sekretarisë së Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave të procedurës “Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinarë”. Data e skadencës së mostrave në ditën e dorëzimit, të jetë jo më pak se 1 (një) vit.

Nr	Përshkrimi i mallrave	Njësia
1	Shiringa 2 cc ml +age	copë
2	Shiringa 5 cc ml +age	copë
3	Vaksina Tërbimi 2 UI shtami Pasteur RIV	fl
4	Vigona Ngjyrë Blu 22 g	copë
5	Anestetikë ndërhyrje operative për qen	fl
6	Amoxicilinë La 100 ml	fl
7	Ivermectinë 100 ml	fl
8	Lincospectinë 100 ml	fl
9	Betadinë	ml
10	Alkool	ml
11	Spray Postoperator oxytetraciline 3.58% 140 gr	fl
12	Ujë i oxigjenuar	ml
13	Serume Ringer 500 ml	copë
14	Serume Glukoze 5 % 500 ml	copë
15	Doreza Sterile Nr.6 Nr.8	copë

16	Doreza jo Sterile Nr.6 Nr. 8	copë
17	Suture USP Nr.1 PGA+age	copë
18	Bisturi Nr.21	copë
19	Garza Sterile 10*10 cm	copë
20	Mbulesa një përdorim sterile	copë
21	Rapid test Leishmania	test
22	Matrikuj për qen	copë
23	Përparëse operimi një përdorimshe	copë
24	Doreza për kapjen e qenve	copë
25	Maska për qen (masa M-L)	copë
26	Lak special për kapjen e qeneve	copë
27	Zinxhir qafe	copë
28	Çizme Llastiku	copë
29	Vaksinë DHP+Lepto	copë
30	Fipronil 10-25 kg	copë
31	Dexametazon 50 ml	fl
32	Enrofloxacinë 10% 100 ml	fl
33	Qese 1 m * 70 cm	kg
34	Maska operacioni një përdorimëshe	copë
35	Pinca Hemostatike	copë
36	Pinceta me dhëmbë	copë
37	Tasa ushqimi	copë
38	Ushqim për qen	kg

III.1.3. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Modifikimin e specifikimeve teknike Shtojca 10 Dokumentat Standarde të Tenderit, si më poshtë vijon:

*Zëri Nr.5 ishte Anestetik ndërhyrje operative për qen njësia flakon ndërkohë do të bëhet **Anestetik për ndërhyrjet operative për qen secili flakon kërkohet në intervalin nga 30 ml deri në 50 ml***

*Zëri Nr.11 ishte Spray Postoperator oxytetraciline 3.58% 140 gr ndërkohë do të bëhet **Spray postoperativ, lënda aktive oxytetraciline me përqëndrim 3.58 % e sipër***

*Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje shtyhet nga data 19.08.2019, ora 11:00 në: datën **02.09.2019, ora 11:00.***

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Në nenin 23, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”.

III.1.6. Në nenin 27 pika 6 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.7. Në dokumentat e tenderit, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i Ofertës”, është përcaktuar shprehimisht: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.1.8. Nëpërmjet shkresës nr.1532/2 datë 07.10.2019 me objekt “Dërgim informacioni”, janë depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik edhe mostrat e dorëzuara nga operatorët ekonomik pjesmarrës.

III.1.9. Referuar pretendimeve të ankimuesit, argumentave të sjella nga autoriteti kontraktor si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Shedula” shpk, konstatoi se mostra me numër rendor 30 Fipronil 10-25 kg e dorëzuar nga ky i fundit nuk është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Konkretisht për artikullin 30 Fipronil 10-25 kg autoriteti kontraktor ka kërkuar pikërisht këtë produkt për qen me peshë 10-25 kg. Nga verifikimi fizik i mostrës së dorëzuar nga operatori ekonomik “Shedula” shpk rezulton se është dorëzuar Fipronil me përshkrim tek pulla origjinale qen me peshë 10-20 kg cka rezulton jo në përputhje me specifikimin teknik të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Akoma më tej KPP vëren se operatori ekonomik “Shedula” shpk ka kryer veprime për modifikimin e mostrës pasi mbi pullën origjinale e cila ka përshkrim qen 10-20 kg ka vendosur disa pulla të tjera me përshkrim qen 10-25 kg. KPP gjykon se këto ndërhyrje për modifikimin e mostrave janë veprime të paligjshme të cilat nuk duhet të kalonin pa u vënë re edhe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi dukshëm operatori ekonomik “Shedula” shpk është përpjekur të kryejë veprime manipuluese mbi mostrën e paraqitur duke modifikuar përshkrimin e saktë të saj.

Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të prodhuar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Në rastin konkret mostra për artikullin me numër rendor 30 Fipronil 20-25 kg e dorëzuar nga operatori ekonomik “Shedula” shpk përvec faktit që nuk është në përputhje me atë që ka kërkuar autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, janë bërë gjithashtu nga ana e tij përpjekje për modifikimin në përshkrimin e saktë të saj gjë që është tërësisht e palejueshme.

III.1.10. KPP gjykon se dorëzimi i mostrave jo në përputhje me specifikimet teknike përbën shkak për skualifikim në përputhje me nenin 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Milifar” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Milifar” sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë “Shedula” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës në shqyrtimin administrativ pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Shedula” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Milifar” sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë “Vetefarm Jugu” shpk Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për

kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Milifar” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-31521-07-25-2019, me objekt “*Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare*”, me fond limit 16,499,987 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 02.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Shedula” shpk duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Milifar” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1532 Protokoli; Datë 26.09.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha